



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr. 23, datë 14.12.2022

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin dhjetor, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 15:15

Data e mbajtjes së mbledhjes : 14.12.2022

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z. Elio Jani dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje !

Të nderuar Këshilltarë! I nderuar Zëvendëskryetar! Të nderuar të Pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë radhe për muajin dhjetor të Këshillit Bashkiak Durrës, të kërkuar nga kryetarja e bashkisë. Janë propozuar 3 projektvendime me relacionet përkatëse. I gjithë dokumentacioni Ju është vënë në dispozicion në postën elektronike nga sekretarja e këshillit. Ftoj sekretaren e këshillit të bëj prezencën në sallë.

Dorina Milja: Fillojmë me prezencën.

Jolanda Mustafaraj ... prezent.....deri tek.... Morena Boja...prezent.

Kryetar ke 31 këshilltarë në sallë.

Ani Dyrmishi : Atëherë, faleminderit.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Po kaloj në leximin e rendit të ditës. Sot për miratim kemi 3 pika.

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE PËRFITUESE PËR STREHIM SOCIAL TË PËRKOSSHËM NË APARTAMENTET E LIRA NË PALLATET E NDËRTUARA NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ
2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE SHITESË TË ALOKUARA NË ZBATIM TË AKTIT NORMATIV NR.17, DATË 01.12.2021 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.115/2021 “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”, TË NDRYSHUAR
3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT DHE DETAJIMIT TË SHITESËS SË FONDEVE TË RINDËRTIMIT PËR VITIN 2022, AKORDUAR NË FORMËN E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA PALLAT DHE NJËSI INDIVIDUALE, SI DHE RIKONSTRUKSIONIN DHE RIPARIMIN E MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLAT) NË BASHKINË DURRËS

Në lidhje me rendin e ditës ka komente nga ana këshilltarëve?

Nuk ka komente, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 31 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike.

Alneida Rroshi: Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Ligjore pasi mori në shqyrtim relacionin dhe projektvendimin për pikën 1 të rendit të ditës propozon me shumicë votash për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj.Rroshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Etleva Budini.

Etleva Budini: Edhe Komisioni ynë votoi unanimitisht për kalimin në votim në këtë mbledhje të kësaj liste përfituesish, por në një diskutim që patëm sot me disa nga anëtarët e komisionit tonë për shkak të kohës së shkurtër që patëm për të shqyrtuar materialet vendosëm që të votohej sot por me kushtin që të bëhet një korigjim për të qënë më në rregull juridikisht. Të bëhet një korigjim në projektvendimin e sjell nga bashkia. Për këtë kolegu im Artioni mund ta sqarojë më mirë.

Ani Dyrmishi : Po Artion.

Artion Beqiraj : Po, përshëndetje .

Ne si komision e diskutuam këtë pikë dhe diskutuam që vendimi është shumë i dobishëm, sepse zgjidh një problem për 15 familje që në fakt kanë prej vitesh në këtë komunitet dhe është i

mirëpritur për t'i sistemuar ata banorë në banesa e sidomos në prag festa. Jemi të mendimit që në zbardhje të projektvendimit të plotësohet duke u bazuar tek koncepti i sistemimit në këto banesa dhe duke u hequr një term që është vendosur "... deri në mirtatimin e një akti ligjor tjetër...", pasi "Ne" nuk mund të shprehemi për organet e tjera, por nëse një akt do të dali do jetë ndryshues, miratues etj, etj...dhe do e marrë vet efektin, pra bazohemi tek koncepti i sistemimit të këtyre banorëve dhe nëse do të ketë një akt tjetër që do ta ndryshoj apo miratojë ai do hyj vet në fuqi dhe "Ne" do të diskutojmë prap. Pra, për këto banorë është e rëndësishme që marrin një zgjidhje dhe këtu bazohet dhe këshilli bashkiak për këtë vendim. Pra, në zbardhje të bëhen ndryshimet.

Ani Dyrmishi : Pra propozimi juaj është : Për miratimin e listës së familjeve përfituese për sistemimin në apartamentet e lira në pallatet e ndërtruara në zonën e re për zhvillim në njësinë administrative Manëz...Kjo është ideja?

Artion Beqiraj : Të hiqet dhe togfjalëshi vëzhgues pastaj... deri në miratimin e aktit
Vendimi të jetë i njëjti më ndryshimet përkatëse në zbardhje.

Ani Dyrmishi : Do jetë dhe relacioni përkatës për tu kryer ndryshimet nga sekretaria.
Ky është propozimi juaj.
Atëherë, Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës.

Etleva Velçani: Faleminderit Kryetar.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin ra dakort për kalimin në votim dhe jemi pro dhe ndryshimeve që sapo u propozuan. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Atëherë përsa i përket pikës 1, komente nga ana e këshilltarëve kemi?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro me gjithë ndryshimet e propozuara nga këshilltari z.Artion Beqiraj?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 31 vota pro miratohet dhe pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 2**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj.Morena Boja.

Morena Boja : Faleminderit.

Komisioni i Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave pasi mori në shqyrtim me mjete të komunikimit elektronik pikën 2 të rendit të ditës "Për miratimin e përdorimit të fondeve shtesë të alokuara në zbatim të Aktit Normativ nr.17, datë 01.12.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar", votoi pro kalimit për votim në mbledhjen e sotme të pikës 2 të rendit të ditës. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj.Boja

Atëherë përsa i përket pikës 2, kemi komente nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 31 vota pro miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 3**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave.

Morena Boja : Dhe për pikën 3 të rendit të ditës, Komisioni i Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave votoi pro kalimit për votim në mbledhjen e këshillit bashkiak. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Boja.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini: Gjithashtu dhe Komisioni ynë me shumicë votash vendosi pro miratimit të përdorimit të këtij fondi shtesë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Budini.

Përsa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 31 vota pro miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.

Fjalën nuk e ka kërkuar asnjë këshilltarë.

Meqenëse pikat e rendit ditës mbaruan mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Për mbledhjen e radhës do të njoftoheni nga sekretaria e këshillit.

Ky proçesverbal mbyllet me nr. rendor 5 (pesë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit, sipas Rregullores Këshillit dhe Proçesverbalit të Kryesisë dhe 2 Kryetarëve të Grupeve Politike në Këshill së datës 09.06.2022.

Mbajtësi i proçesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Zëvendëskryetare e Këshillit :

ZAMIRA MUSTAFARAJ (mungon)

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI